

Programi individual

A dëshiron një fillim të ri?

A dëshiron të studijosh në një program që është posaqërisht i përshtatur për ty?

A dëshiron të shkosh në një grup të vogël?

A dëshiron të bëjsh praktikën në një vend pune?

A dëshiron të fillosh më vonë në një program të zakonshëm të gjimnazit?

Në atë rast, Programi individual mund të jetë për ty.

Nëse studijon në një program individual që është formuar për pikërisht ty, mund të marrësh notën kaluese që të vazhdosh në mënyrë të zakonshme në një program kombëtar.

Një program individual mund të përmbajë përafërsisht të njejtat kurse sikur programi gjimnazial që ke dëshirë të ndjekësh. Ndoshta disa nga kurset mund t'i bësh së bashku me nxënës që janë në një program kombëtar. Ose ndoshta ke nevojë për një ambient tjetër që të jeshë i motivuar me qëllim që ta gjejsh mënyrën tënde të mësimit?

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Kur e ndjek një program individual, do të jepet mundësia që të bësh praktikën poashtu edhe kulifikimin te një vend pune ku do të mësosh një profesion. Kjo mund të rezultojë që të punësohesh te kompanitë pas gjimnazit.

Nëse dëshiron të vazhdosh studimet pas gjimnazit, mund të zgjedhësh kurset e programit tënd individual me anë të së cilave do të mund të ndjekësh një program të zakonshëm gjimnazial. Pas kësaj, mund t'i vazhdosh studimet.

Punë ku mund të pranohesh

Nuk mund të shprehemi në lidhje me cilat punë mund t'i kërkojsh në përgjithësi pasi që i ke përfunduar studimet te një program individual. Kjo varret nga përbërja e programit tënd.

Nëse e di se çfarë lloj punë dëshiron të kesh në ardhmëri, mund të flasësh me udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve që të të ndihmojë për gjetjen e kurseve të cilat do të duhet t'i ndjekësh.

Kontakte me tregun e punës

Te programi individual ke mundësi të mëdha që të jesh te një vend pune gjatë një apo disa ditëve të një jave. Sa ditë, dhe ku, varret nga ajo që të nevojitet dhe nga dëshirat e tua.

Në disa komuna mund t'i kombinosh studimet e tua me punë në një kompani, ku do të mësosh një profesion. Kjo quhet kualifikim çiraku. Mund të pyesësh udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve në rast se komuna yte organizon kualifikime çirakësh.

Ardhmëri dhe punë

Pasi që programi individual është i përshtatur sipas teje, nuk mund të thuhet se në rast se do të jetë e lehtë apo e vështirë që të pranohesh në punë më pas. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve se në rast se ka punë në atë lëmi që të intereson ty. Mund të lexosh për punë të llojeve të ndryshme të informacionet e programeve kombëtare.